



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr 19, date 11/03/2002

PER
DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NE VENDIMIN NR.6 DATE 26.01.2001
“PER VENDOSJEN E GJOBAVE NGA BASHKIA TIRANE”

Në mbështetje të ligjit Nr.8652 dt.31.07.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, Ligjit Nr.7697 dt.07.04.1993 “Për kundravajtje administrative”, neni 3 dhe 5 Ligjit Nr.8343 dt.06.05.1998 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7697 dt.07.04.1993 “Për kundravajtjet administrative” ndryshuar me Ligjin Nr.7813 dt.14.04.1995 dhe Ligjin Nr.8016 dt.25.10.1995, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.6 dt.26.01.2001 “Mbi vendosje e gjobave nga Bashkia Tiranë”, Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.65 dt.20.07.2001 “Mbi organizimin dhe përcaktimin e strukturës së Policisë Bashkiake” me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak.

V E N D O S I

Në Vendimin Nr.6 datë 26.01.2001 të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 5 të këtij vendimi të shtohen gërma “gj” me këtë përmbajtje”

gj) Mospajisje me leje për ushtrimi ambulator nga Bashkia Tiranë.	5.000 lekë
--	------------

2. Pika 8 e këtij vendimi ndryshon si vijon:

Vendosja e gjobave, për pikat 1,2,3 dhe 4, të behen nga Drejtoria e Inspektoriatit të Mjedisit Urban dhe Policisë Bashkiake në bashëpunim me Drejtoritë e Ndërmarrjeve Denoncuese sipas specifikës, ndërsa për pikat 5 dhe 6 të bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tregjeve dhe Taksave dhe Policia Bashkiake. Vjelia e tyre të bëhet prane Drejtorisë së Përgjithshme të Tregjeve dhe Taksave.

3. Pika 9 e këtij vendimi ndryshon si vijon:

Të ardhurat e realizuara nga gjobat e vjelura, të ndahen si vijon:

- | | |
|----------------------|-----|
| a) Bashkia Tiranë | 90% |
| b) Policia Bashkiake | 10% |

Të ardhurat sipas pikës 9.b, në bazë të proces-verbaleve të rakorduara për shumatat e arkëtuara midis kësaj strukture dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tregjeve dhe Taksave, të përdoren nga Policia Bashkiake për shpërblimin e punonjësve të kësaj strukture, mbasi shuma e arkëtuar të kalojë prej 20.000.000 lekësh në vit.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Ekonomike, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Policia Bashkiake, Drejtoria e Kontrollit mbi Territorin dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tregjeve dhe Taksave.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes.

KRYETARI
Leonidha TOSKA